URDHËRESË
Nr.6, datë 25.5.1990

PËR KREDITIN BANKAR

Në mbështetje të ligjit nr.7377, dastë 8.5.1990 "Për Bankën e Shtetit Shqiptar", dhe të ligjit nr.7378, datë 8.5.1990 "Për bankën bujqësore", Këshilli i Ministrave nxjerr këtë

URDHËRESË:

KREU I
KREDITI BANKAR AFATSHKURTËR DHE NDËRMARRJET

Neni 1

Banka e Shtetit Shqiptar dhe Banka Bujqësore u japin ndërmarrjeve e institucioneve që kanë veprimtari prodhuese, kredi për të plotësuar detyrat e planit të prodhimit, të shpërndarjes e të qarkullimit. Kredia planifikohet dhe u jepet ndërmarrjeve, duke u bazuar në natyrën e veçoritë e degëve të ndryshme të ekonomisë socialiste, për të plotësuar nevojat për mjete xhiruese.

Neni 2

Banka e Shtetit Shqiptar dhe Banka Bujqësore u japin ndërmarrjeve kredi afatshkurtër:

1. Për plotësimin me pjesëmarrje të nevojave të planifikuara të mjeteve xhiruese, pasi përcaktohet normativa e mjeteve të veta të xhiros për elementet materiale, të llogaritura, mbi bazën e nevojave të tremujorit mëtëvogël. Mjetet financiare që do t'u tërhiqen ndërmarrjeve nga ulja e pjesëmarrjes së mjeteve të veta të xhiros, fillimisht do të kalojnë në gjendjen e arkëssë buxhetit të shtetit për t'u përdorur si burim krediti.
2. Për nevoja të përkohshme, për tejkalimin e detyrave të planit, për përmirësimin e cilësisë, për vlera materiale që janë përkohësusht mbi nevojat e normuara të mjeteve të veta xhiruese, të rrjedhura nga faktorë që nuk varen nga puna e ndërmarrjes, por që nuk përbëjnë vlera materiale me qarkullim të ngadalshëm e stoqe.

Neni 3

Banka e Shteit Shqiptar dhe Banka Bujqësore japin kredi me interesa më të larta:

a) Ndërmarrjeve që dalin për herë të parë me humbje të paplanifikuar, pasi të përcaktohen masa konkrete që garantojnë mbulimin e humbjes.

b) Ndërmarrjeve që krijojnë paaftësi paguesew, prëtë mos rënduar gjendjen financiare të ndërmarrjeve që realizojnë planin.

Për kreditë e dhëna sipas pikave "a" dhe "b" të këtij neni banka, në bashkëpunim me organet përkatëse ndjek e kontrollon plotësimin e detyrave ekonomiko-financiare të ndërmarrjeve dhe kthimin e kredive të dhëna.

Neni 4

Krediti afatshkurtër jepet me kusht që të përdoret për qëllimin e caktuar, të garantohet me vlera materiale e punime të kreyra dhetë kthehet në afat.

KREU II
KREDITI BANKAR AFATGJATË PËR NDËRMARRJET

Neni 5

Banka e Shtetit Shqiptar dhe Banka Bujqësore u japin ndërmarrjeve e institucioneve që kanë veprimtari prodhuese kredi afatgjatë për:

a) Investime të reja me karakter prodhues e shërbime dhe për rikonstruksione teknike e teknologjike të objekteve ekzistuese prodhuese, me përjashtim të investimeve që financohen nga buxheti i shtetit, si për hidrocentrale, hekurudha, naftë, gjeologji, ujëmbledhës, pyje, kullota etj.

b) Investime që kanë lidhje me nismat që lindin gjatë vitit për zgjerimin e prodhimit, mekanizimin dhe përsosjen e mëtejshme të teknologjisë së prodhimit.

Kredia afatgjatë jepet për investimet që kanë leverdi ekonomike, në bazë të dokumentacionit që ndërmarrjet depozitojnë në bankë, dhe garantohet kthimi i saj.

Neni 6

Banka e Shtetit Shqiptar dhe Banka Bujqësore, për objektet e investimet e kredituara, ndjekin e kontrollojnë kryerjen e punimeve sipas projekteve e preventivave, venien në shfrytëzim në afat të tyre dhe realizimin e treguesve të efektivitet, deri në shlyerjen e plotë të kredisë.

KREU III
KREDITI BANKAR PËR KOOPERATIVAT BUJQËSORE

Neni 7

Kur kooperativat bujqësore nuk përballojnë nevojat me mjetet e tyre monetare, Banka Bujqësore u jep kredi afatshkurtër, me kusht që të përdoret për qëllimin e caktuar, të garantohet me vlera materiale dhe të kthehet në afat. Kjo kredi jepet për:

a) Shpenzimet e provcesit stinor të prodhimit, me përjashtim të atyre që mbulohen nga përdorimi i prodhimeve të vetë koopreawtivave bujqësore, si dhe për pagimin e primeve tësigurimeve të pasurisë së kooperativës bujqësore.

b) Paradhëniet për shpërblimin e punës së anëtarëve, sipas dispozitave të veçanta të Këshillit të Ministrave.

c) Investimet dhe ndërtimet themelore, kundrejt maturimit të fondit vjetor që do të krijohet sipas planit.

ç)Vleftën e drithit të bukjës së papërdorur, të prodhimeve industriale të artizanatit që janë përfshirë në vlerën e ditë-punës, si dhe për shlyerjen e llogarisë me anëtarët. Kredia jepet kur kooperativa bujqësore nuk ka mjetet e veta të mjaftueshme, duke përfshirë edhe fondin e garantimit të pagës.

d) Mbulimin e shtesës së vleftës së ushqimeve të silazhuara, të barit, të jonxhës e të koncentrateve që do të përdoren për blegytorinë në vitin pasardhës.

dh) Mbulimin e shtesës së vleftës së gjendjes në fund të vitit të gjedhëve e të derrave në njësitë e veçanta të majmërisë dhe për shtesën e numrit të krerëve për të gjitha llojet e bagëtive, kur nuk përballohen nga fondet qarkulluese.

e) Mbulimin e shtesës së vleftës së plehut organik që rezulton gjendje në fund të vitit.

ë) Blerjen e drithërave të bukës opër kooperativat bujqësore që furnizohen nga shteti.

Neni 8

Banka Bujqësore u jep kooperativave bujqësore kredi afatgjatë, kur nuk kanë fonde të mjaftueshme për investime të reja me karakter prodhues, për rikonstruksione teknike e teknologjike të objektve prodhuese ekzistuese, për blerjen e farave për kultivimin e bimëve shumëvjeçare, për punime të thella me mjete të mekanizuara, si dhe për shpenzimet që bëhen për riparime kapitale, me kusht që objektet e kredituara të sigurojnë të ardhura neto dhe të garantojnë kthimin në afat të kredisë së dhënë.

KREU IV
KTHIMI I KREDITIT BANKAR

Neni 9

Kredia afatshkurtër për ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore jepet me afat kthimi deri në 12 muaj.

Afatet konkrete të kthimit të kredisë sipas objekteve dhe llojeve të kredisë caktohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit.

Neni 10

Kthimi i kredisë afatgjatë caktohet nga banka, në marrëveshje, me ndërmarrjet e kooperativat bujqësore, brenda afatit të vetëshlyerjes së objektit. Burime për kthimin e kredisë nga ndërmarrjet do të jenë fondi i amortizimit dhe e ardhura neto që realizohet nga objekti i kredituar. Kur kredia nuk kthehet në afat, banka e tërheq atë edhe nga të ardhurat neto për pjesën që i takon financimit të investimeve të ndërmarrjes për aktivitetin tjetër të saj.

Në koopertivat bujqësore kthimi i kredisë bëhet nga fondet e caktuara për investimet dhe kur ato nuk janë të mjaftueshme nga të ardhurat neto.

Kredia afatgjatë për të përballuar shpenzimet për invesime që kanë lidhje me nisma që lindin gjatë vitit për zgjerimin e prodhimit, jepet me afat kthimi jo më tepër se 3 vjet.

Neni 11

Banka e Shteit Shqiptar dhe Banka Bujqësore, kur nuk respektohet disiplina e kreditit, marrin këto masa:

a) kalojnë ndërmarrjet, institucionet e kooperativat bujqësore në kredi të pakthyer në afat, kur ato nuk e kthejnë kredinë sipas kuotave të caktuara dhe kur nuk e garantojnë me vlera materiale.

Kur edhe gjatë tremujorit pasardhës ndërmarrja nuk e kthen kredinë e pakthyer në afat, banka kufizon ose ndërpet kreditimin emëtejshëm të saj.

b) Ndërpresin dhënien e mëtejshme të kredisë afatgjatë, kur vërejnë se nuk është përdorur për qëllimin e dhënë.

c) Ndërpresin dhënien e mëtejshme të kredisë afatgjatë, kur vërejnë se nuk është pëdorur për qëllimin e dhënë, ka shmangie nga destinacioni i investimit dhe nuk garantohet efektiviteti i parashikuar.

ç) Kufizojnë ose ndërpresin kreditimin e mëtejshëm deri nëmasën që kooperativa bujqësore të mbulojë tërësisht shpenzimet e prodhimit dhe paradhëniet me të ardhurat që realizon, kur ajo krijon mosrealizime gjatë vitit dhe nuk garanton kthimin e kredisë.

Për mosrespektimin e disiplinës së kreditit, sipas pikave “b”, “c” e “ç” të këtij neni, banka njofton ndërmarrjen, institucionin e kooperativën bujqësore, ministrinë përkatëse dhe komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit për marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.

KREU V
KREDITI AFATGJATË PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË BANIMIT TË PUNONJËSVE

Neni 12

Banka e Shtetit Shqiptar dhe Banka Bujqësore, duke u mbështetur në vendimin e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të qytetit e të rajoneve për Tiranën dhe të këshillave popullorë të fshatrave të bashkuara, si dhe në dokumentacionin përkatës të dërguar në bankë nga seksioni komunal i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, u jep kredi afatgjatë:

a) Punonjësve të qytetit, të fshatrave e të qendrave të tjera të banuara të ndërmarrjeve bujqësore e të kooperaivave bujqësore për të meremetuar, përshtatur e zgjeruar shtëpitë ekzistuese deri në plotësimin e nevojave me sipërfaqe banimi.

b) Punonjësve të qytetit, të fshatrave e të qendrave të tjera të banuara të ndërmarrjeve

bujqësore u jepet kredi e pjesshme për ndërtimin e banesave të reja vetjake.

c) Punonjësve të fshatrave në ndërmarrjet bujqësore e kooperativat bujqësore, për të rindërtuar e ndërtuar shtëpi të re, kur ekzistuesja dëmtohet ose paraqet rrezik dëmtimi nga fatkeqësitë e natyrës, si shkarjete tokës, përmbytjet, tërmetet etj.

ç) Punonjësve të qyteit e të fshatit, për të përballuar shpenzimet që u takojnë, kur do të restaurohet shtëpie e tyre, që është shpallur monument kulture.

Për punonjësit e qytetve muze ose të lagjeve muze, kur shtëpitë e tyre janë shpallur monumente kulture, duke përfshirë edhe meremetimin e mureve të avllisë e të portave, që kanë tiparet dalluese të shtëpive muze.

Neni 13

Kredia afatgjatë, sipas nenit 12, jepet:

për shkronjën "a" drei në 20 mijë lekë, me afat kthimi për punonjësit e qytetit deri në 10 vjet dhe për ata të fshatrave e të qendrave të tjera të banuara të ndërmarrjeve bujqësore e të kooperativave e të qendrave të tjera të banuara të ndërmarrjeve bujqësore e të kooperativave bujqësore deri në 15 vjet.

Për shkronjën "b" kredia jepet e pjesshme, por jo më shumë se 50 për qind e vleftës së preventivit. Për ndërtim banese të re kufiri maksimal i kredisë është deri në 25 mijë lekë dhe afati i kthimit 5 vjet.

Për shkronjën "c" deri në 35 mijë lekë, me afat kthimi deri në 20 vjet.

Për shkronjën "ç" deri në 35 mijë lejë, me afat kthimi deri në 20 vjet për punonjësit e qytetit dhe deri në 25 vjet për punonjësit e fshatit.

Neni 24

Kredia afatgjatë për përmirësimin e kushteve të banimit dhe plotësimin e nevojave për banim nuk jepet, kur shtëpia ekzistuese dhe ajo që do të ndërtohet e re, nëbazë të planit rregullues të qytetit ose të fshatit do të prishet brenda 10 vjetëve, kur është jashtë vijës kufitare dhe kur nuk është kthyer plotësisht kredia e marrë më parë.

Përjashtim nga kriteret e mësipërme bëhet kur shtëpia është shpallur monument kulture ose është dëmtuar nga fatkeqësitë e natyrës.

Neni 15

Për kredinë e miratuar punonjësi i lëshon degës së bankës aktdetyrimin, që është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga përmbarues gjyqësor.

Neni 16

Kthimi i kredisë bëhet:

a) Për punonjësit që janë në marrëdhënie pune me shtetin dhe për anëtarët e kooperativave bujqësore me ndalesa mujore nga paga ose nga paradhënia për ditë-pune e normë-punë, ditën e tërheqjes së tyre.

b) Për pensionistët me ndalesa mujore nga pensioni në ditën e tërheqjes së tij.

Neni 17

Kur kredimarrësi vdes, për kthimin e kredisë zbatohet dispozita për trashëgiminë.

Kur shtëpia, për të cilën është dhënë kredi, shpronësohet, kredia e mbetur shlyhet nga ndërmarrja, institucioni ose kooperativa bujqësore që është investitor.

Neni 18

Shtëpia, për të cilën është dhënë kredi, nuk mund të shitet ose të dhurohet pa u shlyer kredia e bankës.

Neni 19

Kredia afatgjatë për përmirësimin e kushteve të banimit dhe plotësimin e nevojave për banim jepet kur punimet merren përsiër me kontratën dhe kryhen nga ndërmarrjet komunale, ndërmarrjet bujqësore e kooperatrivat bujqësore, si dhe nga degët e atelietë e monumenteve të kulturës për shtëpitë që janë shpallur monument kulture. Në raste të veçanta, kur punonjësi e ndërton vetë shtëpinë, mund të jepet kredi për blerjen e një pjese të materialeve.

KREU VI
PLANIFIKIMI I KREDITIT BANKAR

Neni 20

Plani i kreditit bankar parashikon nevojat dhe burimet e mbulimit të tyre.

Në bazë të metodologjisë së planifikimit të ekonomisë socialiste, ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore hartojnë projektplanin e kreditit afatshkurtër e afatgjatë dhe ua dërgojnë përkatësisht, degës së Bankës së Shtetit Shqiptar, degës së Bankës Bujqësore dhe seksioneve përkatëse të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

Degët e Bankës së Shtetit Shqiptar dhe ato të Bankës Bujqësore, së bashku me seksionet e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, pasi shqyrtojnë projektplanin e kreditit të ndërmarrjeve e të kooperative bujqësore, hartojnë projektplanin e kreditit në shkallë rrethi. Pas niratimit nga komitete ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, ata ua dërgojnë projektplanin e kreditit, përkatësisht Drejtorisë së Bankës Bujqësore dhe ministrisë përkatëse.

Projektplani i kreditit afatshkurtër e afatgjatë hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar dhe nga Drejtoria e Bankës Bujqësore brenda afateve të caktuara në metodologjinë e planifikimit të ekonomisë socialiste, në bazë të projektplaneve të kreditit të dërguara nga degët e bankës dhe nga ministritë e institucionet e tjera qendrore, si vjetor dhe në tremujorë sipas rretheve.

Këshilli i Ministrave miraton planin e kredisë afatshkurtër për ndërmarrjet, institucionet dhe kooperativat bujqësore për tepricë në fund të vitit. Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar dhe Drejtoria e Bankës Bujqësore miratojnë për çdo rreth planin e kredisë afatshkurtër prë ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore për tepricën në fund të çdo tremujori.

Këshilli i Ministrave miraton planin vjetor të kredisë afatgjatë për ndërmarrjet e kooperativat bujqësore, për përdorimin vjetor dhe për tepricën në fund të vitit. Drejtoria e përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar edhe Drejtoria e Bankës Bujqësore miratojnë planin e kredisë afatgjatë për ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore për përdorimin tremujor dhe për tepricën në fund të çdo tremujori për çdo rreth.

Neni 21

Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar dhe Drejtoria e Bankës Bujqësore, pas miratimit të planit të kredisë, ua dërgojnë si vjetore e në tremujore ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve e rajoneve për Tiranën, si dhe degëve të bankës në rrethe, sipas ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore.

Dega e Bankës së Shtetit Shqiptar dhe dega e Bankës Bujqësore, së bashku me sesionet përkatëse të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, bëjnë ndarjen e planit të kredisë në tremujorë prë të gjitha ndërmarrjet e kooeperativat buuqësore të rrethit.

Neni 22

Brenda planit tremujor të kreditit:

a) Dega e Bankës së Shtetit Shqiptar dhe dega e Bankës Bujqësore kanë të drejtë të bëjnë ndryshime në planin e kredisë nga njëra ndërmarrje në tjetrën, brenda të njëjtit sistem dhe nga një kooperativë bujqësore ë tjetrën.

b) Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së shtetit Shqiptar dhe Drejtoria e Bankës Bujqësore me

kërkesë e ministrisë ose të institucionit tjetër qendror, kanë të drejtë të bëjnë ndryshime në planin e kreditit nga një rreth në tjetrin.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 23

Banka e Shtetit Shqiptar dhe Banka Bujqësore, për kredinë afatshkurtër dhe kredinë afatgjatë, marrin interes bankar sipas dispozitave të veçanta.

Neni 24

Personeli drejtues adrministrativ, inxhinieri-teknik e ekonomik i ndërmarrjeve dhe i institucioneve, si dhe kuadri komandues e ushtarakë të tjerë që kanë funksione drejtuese në njësitë e bashkuara e reparte ushtarake, si dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për shkeljen e dispozitave të kësaj urdhërese, kanë përgjegjësi materiale gjer në masën e një page mujore.

Neni 25

Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit dhe Drejtoria e Bankës Bujqësore ngarkohen të lëshojnë udhëzimet përkatëse për zbatimin e dispozitave të kësaj urdhërese.

Neni 26

Urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr.4, datë 231.9.1982 “Për kreditin bankar”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë urdhëresë, shfuqizohen.

Neni 27

Kjo urdhëresë hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI